

VENDIM
Nr. 367, datë 6.5.2020

PËR SHEMBJEN E TETË OBJEKTEVE TË DHËNA ME QIRA ME KONTRATËN E QIRASË NR.1823 REP., NR.867 KOL., DATË 13.9.2019, ME TARIFËN 1/EURO KONTRATA, TË LIDHUR NDËRMJET MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË, SI QIRADHËNËS, DHE SHOQËRISË “ROZAFI”, SH.P.K., SI QIRAMARRËS, NË ADMINISTRIM TË MINISTRISË SË MBROJTJES

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të aktit normativ me fuqinë e ligjit nr.4, datë 9.7.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve”, miratuar me ligjin nr.9967, datë 24.7.2008, të ndryshuar, dhe në vijim të pikës 7, kreut VIII, të vendimit nr.54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontratave të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shembjen e tetë objekteve me emërtimet nr.1 “Depo”, nr.2 “Depo”, nr.3 “Depo”, nr.4 “Depo”, nr.5 “Depo”, nr.6 “Truprojë”, nr.7 “Objekt rrënojë”, nr.8 “Banjo”, me sipërfaqe totale ndërtimore 4.185.48 m², të dhëna me qira me kontratën e qirasë nr.1823 rep., nr.867 kol., datë 13.9.2019, me tarifën 1/euro kontrata, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si qiradhënës, dhe shoqërisë “Rozafa”, sh.p.k., si qiramarrës, pjesë të pasurisë për pronën nr.338, me emërtim “Ish-reparti ushtarak nr.5012/20”, me vendndodhje në Çekrez, Gramsh, me sipërfaqe të përgjithshme 28 960 m², nga ku sipërfaqe ndërtimore 4185.48 m² dhe sipërfaqe funksionale 24 774.52 m², me nr.pasurie 257/1, zona kadastrale 2167, në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes, sipas tabelës për nxjerrjen jashtë përdorimit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Mbrojtjes dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Tabela perobudilnic v obliki tveganja za prenosno pot: izbrani podatki o obsegu in vrednosti

Št.	Ime in priimek osebje	Ime in priimek kontraktora	Ime in priimek subjekta	Vredn. oblikovanja	Vredn. oblikovanja (t.i.)	Vredn. oblikovanja (t.i.)	Amortizacija (t.i.)	Vredn. oblikovanja (t.i.)
1	arobn	J.B. Čukar, Črnomelj	Erpenj	1322	1322,00	6952100	323200	1026900
2	arobn	J.B. Čukar, Črnomelj	Erpenj	1060	1060,00	6952100	323200	841800
3	arobn	J.B. Čukar, Črnomelj	Erpenj	1260	1260,00	6952100	323200	936800
4	arobn	J.B. Čukar, Črnomelj	Erpenj	1376	1376,00	6952100	323200	1022800
5	arobn	J.B. Čukar, Črnomelj	Erpenj	1593	1593,00	6952100	323200	1269800
6	arobn	J.B. Čukar, Črnomelj	Trzin	1272	1272,00	372800	60340	1088600
7	arobn	J.B. Čukar, Črnomelj	Erpenj	1272	20	125200	60340	768600
8	arobn	J.B. Čukar, Črnomelj	Erpenj, ...	1276	20	125600	60340	1099600

Dokument
oblikovalni tveganje